

## **Projektligj-LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

### **PËR NISMËN LIGJVËNËSE POPULLORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e dhjetë deputetëve,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

#### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi i ligjit**

1. Ky ligj përcakton parimet, rregullat dhe procedurat në bazë të të cilave ndërmerret nisma ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet kushtetuese dhe iniciativën popullore evropiane.

2. Nisma ligjvënëse popullore ka qëllim zgjerimin e përfshirjes së shtetasve shqiptarë në proceset vendimmarrëse dhe realizohet nëpërmjet nënshkrimeve të tyre në mbështetje të saj. Procedurat e detajuara për ushtrimin e kësaj nisme rregullohen në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe në praktikën më të mirë në këtë fushë.

##### **Neni 2**

##### **Parimet bazë**

1. Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote mund të marrë pjesë në procesin e nismës ligjvënëse popullore dhe gëzon të drejta të barabarta.

2. Ndalohet çdo lloj diskriminimi apo kufizimi në procesin e propozimit të draft-ligjeve, bazuar në shkaqe të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi fetar, bindjet politike apo bindje të tjera, origjina kombëtare apo sociale, prona, gjendja ekonomike dhe sociale, orientimi seksual, lindja, paaftësitë fizike, apo shkaqe të tjera personale.

Procesi i nismës ligjvënëse popullore zhvillohet në respektim të të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë në respektim të lirisë së shprehjes dhe të drejtës për t'u informuar, lirisë së lëvizjes brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të së të drejtës për t'u organizuar lirisht dhe për t'u organizuar për qëllime politike

### Neni 3 Përkufizime

1. **'Shtetas'** është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë me të drejtë vote, sipas Nenet 45 të Kushtetutës së RSH.
2. **'Nismë ligjvënëse popullore'** është propozimi popullor i iniciuar nga jo më pak se 20 000 zgjedhës, i cili ka për qëllim paraqitjen e një projektligji për miratim në Kuvendin e Shqipërisë ose propozimin për miratimin e një ligji nga vetë Kuvendi.
3. **'Përfaqësuesi / Komiteti Përfaqësues i Nismës ligjvënëse popullore'** – shtetasi/t që marrin pjesë në nismën ligjvënëse qytetare dhe përzgjidhen nga grupet sociale, individët e angazhuar në veprimtari civile dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim përfaqësimit e nismës në Kuvendin e Shqipërisë, në institucionet e tjera, si dhe përpara qytetarëve.
4. **'Regjistrimi i nismës ligjvënëse popullore'** është procesi i regjistrimit formal të nismës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas paraqitjes së kërkesës nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës.
5. **'Grupi i Mbledhjes së Nënshkrimeve'** është struktura përgjegjëse për mbledhjen e nënshkrimeve në vendet publike dhe përbëhet nga dy anëtarë të cilët caktohen nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës nga radhët e aktivistëve të grupeve sociale, qytetarëve të angazhuar apo organizatave të shoqërisë civile që kanë iniciuar nismën. Anëtarët e GMN duhet të jenë shtetas shqiptarë që gëzojnë kushtet për të qenë zgjedhës.
6. **'Memorandum Bashkëpunimi'** janë marrëveshje paraprake bashkëpunimi ndërmjet organizatave të shoqërisë civile si dhe ndërmjet tyre dhe grupeve sociale e qytetarëve të angazhuar që mbështesin nismën dhe përcaktojnë modalitetet e inicimit të nismës, koordinimit dhe mbarëvajtjes në tërësi të procesit të nismës ligjvënëse popullore, deri në depozitim të kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë.
7. **'Vende publike të mbledhjes së nënshkrimeve'** janë hapësira publike ku realizohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve të mbështetësve të nismës dhe miratohen nga Këshillat Bashkiakë.
8. **'Fletët e mbledhjes së nënshkrimeve'** janë fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve të mbështetësve të nismës të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas përcaktimeve të këtij ligji.
9. **'Zgjedhës të asistuar'** janë mbështetësit e nismës ligjvënëse popullore që për shkak të pamundësive fizike asistohen nga shtetas të tjerë për të shprehur vullnetin e tyre pro nismës.
10. **'Verifikim i Nënshkrimeve'** është procesi i verifikimit të fletëve të nënshkrimeve në të gjithë komponentët e saj dhe të të dhënave të mbështetësve të nismës ligjvënëse që realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të këtij ligji.
11. **'Nënshkrim elektronik'** janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar.
12. **'Portal i mbledhjes së nënshkrimeve online'** është portali elektronik i cili mundëson mbledhjen online të nënshkrimeve të mbështetësve të nismës ligjvënëse popullore.

**13. 'Certifikatat e nënshkruesve online'** janë vërtetime elektronike, të cilat lidhin kodet kontrolluese të nënshkrimeve me një person dhe konfirmojnë identitetin e tij në procesin e nënshkrimit online në mbështetje të nismës ligjvënëse popullore.

**14. 'Afat kohor'** është koha e llogaritur në ditë pune brenda së cilës realizohen procedurat e parashikuara në këtë ligj.

## **KREU II NISMA LIGJVËNËSE POPULLORE**

### **Neni 4**

1. Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote mund të marrë pjesë në procesin e propozimit të ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

2. Në çdo rast, nisma ligjvënëse qytetare duhet të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 shtetas shqiptarë me të drejtë vote, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tij.

3. Të gjitha veprimtaritë për paraqitjen e nismës ligjvënëse popullore dhe projektligjet që i dërgohen Kuvendit kryhen në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Rregulloren e Kuvendit dhe ligjet e tjera përkatëse.

### **Neni 5**

#### **Llojet e nismës ligjvënëse popullore**

1. Shtetasit shqiptarë me të drejtë vote kanë të drejtën e nismës ligjvënëse popullore për:

- a) hartimin dhe paraqitjen e një projektligji përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- b) paraqitjen e një kërkesë dhe parashtrimin e ideve bazë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, për të hartuar një projektligj për çështje të caktuara.

2. Në rast se nisma ligjvënëse qytetare ka për objekt paraqitjen në Kuvend të një projektligji konkret, ai hartohet në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe me standardet e tjera ligjore dhe nënligjore për hartimin e akteve normative.

3. Nëse nisma ligjvënëse paraqitet në kundërshtim me kushtet dhe kriteret sipas pikës 2 të këtij neni, Kuvendi ka të drejtë ta refuzojë atë. Në çdo rast, nisma mund të ri-paraqitet brenda një periudhe kohore jo më vonë se 3 muaj nga dita e paraqitjes së parë, pas plotësimit të kërkesave sipas pikës 2 të këtij neni.

### **Neni 6**

#### **Financimi**

1. Shpenzimet për përgatitjen dhe mbledhjen e nënshkrimeve mbulohen nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënëse. Nismëtarët përcaktojnë paraprakisht mënyrën e mbulimit të shpenzimeve për nismën ligjvënëse nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit.

2. Kostot dhe shpenzimet për përgatitjen e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve përballohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

3. Burimet e financimit të nismës ligjvënëse popullore dhe sasia e financimit për këtë qëllim bëhen kurdoherë publike.

## **Neni 7**

### **Përfaqësuesi / Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënëse popullore**

1. Çdo nismë ligjvënëse popullore ka Përfaqësuesin e saj ose ngre Komitetin Përfaqësues të nismës, i cili përbëhet nga përfaqësues të grupeve sociale ose individë të angazhuar në çështje qytetare si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që e iniciojnë atë. Kushtet e përzgjedhjes dhe mënyra e funksionimit të Përfaqësuesit/Komitetit Përfaqësues të nismës ligjvënëse popullore përcaktohen në mënyrë të detajuar në memorandumet e bashkëpunimit të nënshkruara nga përfaqësuesit e grupeve sociale ose qytetarëve të angazhuar në çështje qytetare, si dhe organizatave të shoqërisë civile që ndërmarrin nismën.
2. Në rastin kur nisma ligjvënëse popullore iniciohet nga grupe sociale apo individë të angazhuar në çështje qytetare, që nuk funksionojnë si organizata të shoqërisë civile, atëherë ato përzgjedhin një Përfaqësues të nismës.
3. Në rastin kur nisma ligjvënëse popullore iniciohet nga organizata të shoqërisë civile nisma përfaqësohet nga Komiteti Përfaqësues, ku secila prej organizatave ka të drejtë të caktojë një përfaqësues.
4. Organizatat e shoqërisë civile që iniciojnë nismën ligjvënëse popullore duhet të jenë organizata shqiptare, të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, që kryejnë aktivitet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo në nivel lokal. Këto organizata duhet të kenë të parashikuar në Statutin e tyre pjesëmarrjen aktive në nisma dhe veprimtari qytetare.
5. Në rastet kur nisma ligjvënëse popullore iniciohet nga grupe sociale apo individë të angazhuar në çështje qytetare në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, përfaqësimi realizohet nga Komiteti Përfaqësues i nismës, i cili përbëhet nga tre anëtarë të përzgjedhur nga kategoria e parë dhe nga një përfaqësues për çdo organizatë të shoqërisë civile.
6. Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës është përgjegjës për fillimin dhe mbarëvajtjen e të gjithë procesit të nismës ligjvënëse popullore, në koordinim dhe komunikim të plotë me institucionet përgjegjëse, në respektim të plotë të së drejtës së qytetarëve për t'u informuar. Ai përfaqëson interesat e komunitetit iniciator të nismës ligjvënëse popullore në raport me të tretët. Modalitetet e funksionimit dhe organizimit të Komitetit Përfaqësues të nismës ligjvënëse popullore përcaktohen nga vetë përfaqësuesit e grupeve sociale apo qytetarëve të angazhuar në çështje qytetare, si dhe organizatave të shoqërisë civile nëpërmjet Memorandumeve të Bashkëpunimit të nënshkruara prej tyre.
7. Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës regjistrohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me anë të një kërkesë formale, që përmban datën, gjeneralitetet e Përfaqësuesit/Komitetit Përfaqësues të nismës, qëllimin e saj si dhe një projekt/draft të projektligjit që kërkohet të miratohet, apo të kërkesës/çështjes që kërkohet t'i parashtrahet Kuvendit për miratim. Kërkesës i bashkëngjitet edhe kopje e Memorandumeve të

Bashkëpunimit të nënshkuara për këtë qëllim, si dhe kopje e noterizuar e Statutit të secilës nga organizatat e shoqërisë civile pjesëmarrëse në nismë.

8. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistron Përfaqësuesin/Komitetin Përfaqësues të nismës jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga paraqitja e kërkesës dhe publikon këtë vendim në faqen zyrtare të internetit së bashku me përbërjen, qëllimin e nismës, Memorandumet e Bashkëpunimit të nënshkuara sipas pikës 7 të këtij neni, listën e organizatave të shoqërisë civile që aderojnë në të, si dhe projekt/draftin e projektligjit që kërkohet të miratohet, apo sipas rastit të kërkesës/çështjes që kërkohet t'i parashtrahet Kuvendit për miratim.
9. Pas regjistrimit të nismës në KQZ, Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës informon publikun lidhur me qëllimin e nismës, aktivitetet publike dhe civile që do të ndërmerren në këtë kuadër, modalitetet e funksionimit dhe organizimit të përfaqësuesve të nismës dhe mbështetësve të saj, si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm me qëllim informimin e publikut, në një gjuhë të thjeshtë e të përshtatshme. Komunikimi zyrtar me publikun realizohet nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të nismës, si dhe nëpërmjet çdo mjeti tjetër komunikimi masiv në medianë dhe elektronike, përfshirë këtu edhe rrjetet sociale.
10. Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës, publikon në faqen zyrtare të saj listat e Grupeve të Mbledhjes së Nënshkrimeve, shoqëruar me vendet përkatëse publike të mbledhjes së tyre, si dhe me të dhënat që përmbajnë fletët tip të miratuara nga KQZ për mbledhjen e nënshkrimeve.

#### **Neni 8**

#### **Njoftimi i Kuvendit për fillimin e procedurave të nismës ligjvënëse popullore**

1. Pas regjistrimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënëse popullore i dërgon Kuvendit të Shqipërisë njoftimin për fillimin e procedurave, së bashku me një dokument përshkruar të detajuar lidhur me llojin dhe qëllimin e nismës, si dhe projektligjin që kërkohet të miratohet, apo të çështjes që kërkohet t'i parashtrahet Kuvendit për miratim.
2. Në çdo rast, Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës pajiset nga Zyra e Protokollit të Kuvendit me një konfirmim me shkrim për datën dhe orën e regjistrimit të kërkesës, dokumentit përshkruar dhe të dokumenteve të tjera, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
3. Një kopje e konfirmimit të Zyrës së Protokollit të Kuvendit për regjistrimin e nismës, sipas pikës 2 të këtij neni depozitohet brenda 48 orëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i Nismës dhe publikohet gjerësisht në medianë dhe shkruar, audiovizive, si dhe në rrjetet sociale me qëllim informimin e publikut.

#### **KREU**

#### **MBLEDHJA E NËNSHKRIMEVE**

#### **Neni 9**

#### **Caktimi dhe miratimi i vendeve publike për mbledhjen e nënshkrimeve**

1. Mbledhja e nënshkrimeve për fillimin e një nisme ligjvënëse popullore realizohet në vende publike, të cilat caktohen me vendim të Këshillit Bashkiak të çdo njësie të qeverisje vendore.
2. Në çdo rast Këshilli Bashkiak miraton numrin e vendeve publike për mbledhjen e nënshkrimeve duke zbatuar rregullin 'një vend publik për çdo 5,000 zgjedhës'.
3. Kërkesa për përcaktimin e vendeve publike për mbledhjen e nënshkrimeve paraqitet në Këshillin Bashkiak nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ose nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës.
4. Çdo Këshill Bashkiak, jo më vonë se 20 ditë pune nga dita e paraqitjes së kërkesës sipas pikës 3 të këtij neni miraton me vendim vendet publike ku do të mbledhen nënshkrimet e zgjedhësve për fillimin e një nisme ligjvënëse popullore.
5. Vendimet për miratimin e vendeve publike për mbledhjen e nënshkrimeve, merren me shumicën e anëtarëve të Këshillit Bashkiak që janë të pranishëm në mbledhje.
6. Vendndodhjet e vendeve të mbledhjes së nënshkrimeve bëhen publike nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës, përmes njoftimit në faqen e internetit të nismës ligjvënëse, si dhe në ambientet e jashtme të çdo njësie të qeverisjes vendore.

### **Neni 10**

#### **Grupet e Mbledhjes së Nënshkrimeve**

1. Mbledhja e nënshkrimeve për fillimin e nismës ligjvënëse popullore realizohet nga Grupet e Mbledhjes së Nënshkrimeve (GMN) në vendet e publike të përcaktuara për mbledhjen e tyre.
2. Grupet e Mbledhjes së Nënshkrimeve (GMN) përbëhen nga dy anëtarë, të cilët caktohen nga Përfaqësuesi ose Komiteti Përfaqësues i nismës nga radhët e aktivistëve të grupeve sociale, qytetarëve të angazhuar apo organizatave të shoqërisë civile që kanë iniciuar nismën, sipas modaliteteve të përcaktuara në Memorandumet e Bashkëpunimit të nënshkruara për këtë qëllim.

### **Neni 11**

#### **Fletët për mbledhjen e nënshkrimeve**

1. Përfaqësuesi apo Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënëse popullore, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga konfirmimi i Kuvendit për regjistrimin e fillimit të procedurave të nismës ligjvënëse popullore, paraqet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një kërkesë me shkrim për pajisjen e tyre me fletët (*fletët tip*) të mbledhjes së nënshkrimeve.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton modelin e listave të mbledhjes së nënshkrimeve brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës sipas pikës 1 të këtij neni dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit.
3. Fleta e mbledhjes së nënshkrimeve, në njërën anë të tyre përmbajnë informacionin lidhur me nismën ligjvënëse popullore që do t'i propozohet Kuvendit, qëllimin e saj, një shpjegim të përmbledhur të saj dhe të dhëna lidhur me Përfaqësuesin apo Komitetin Përfaqësues të nismës. Në anën tjetër, fleta e mbledhjes së nënshkrimeve përmban të dhëna lidhur me Bashkinë dhe vendin e caktuar publik ku realizohet mbledhja e nënshkrimeve,
  - a. numrin rendor
  - b. gjeneralitetet e zgjedhësve që mbështesin nismën
  - c. vendin dhe datën e lindjes

- d. numrin e Kartës së Identitetit apo të Pasaportës të mbështetësve
  - e. kolonën ku ata nënshkruajnë
  - f. emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të GMN që do të përfshihen në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve, si dhe vendin ku ata nënshkruajnë se kanë realizuar këtë proces.
4. Në çdo rast, Përfaqësuesi ose Komiteti Përfaqësues i nismës pajiset me fletët e mbledhjes së nënshkrimeve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara fillimit të procesit. Ky proces realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim me Përfaqësuesin ose Komitetin Përfaqësues të nismës.
  5. Anëtarët e GMN sigurohen që qytetarët të nënshkruajnë vetëm një herë dhe vetëm pasi të kenë plotësuar informacionin e kërkuar në paragrafin 3 të këtij neni.
  6. Nëse për shkak të paafësisë fizike një shtetas më të drejtë vote nuk mund të nënshkruajë fletën, një anëtar i familjes së tij/saj ose një person që e asiston, nënshkruan fletën në prani të tij, sipas udhëzimeve të dhëna prej tij. Në këtë rast, nga GMN mbahet një procesverbal i veçantë ku evidentohet rasti, nënshkruhet prej tyre dhe, depozitohet në KQZ së bashku me fletët e nënshkrimeve.

## **Neni 12**

### **Procedura të veçanta**

1. Nëse një shtetas shqiptar me të drejtë vote nuk është në gjendje të shkojë në vendin e mbledhjes së nënshkrimeve për arsye shëndetësore, GMN bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga ai ose personi që e asiston shkon dhe merr nënshkrimin në vendin ku ndodhet qytetari. Kërkesa i paraqitet GMN, në çdo rast, jo më vonë se ora 12 p.m. e mesditës së ditës së fundit të afatit të mbledhjes së nënshkrimeve. Të gjitha kërkesat e kësaj natyre i bashkëngjiten fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve dhe depozitohen në KQZ, së bashku me to.

2. Mbledhja e nënshkrimeve të shtetasve shqiptarë me të drejtë vote që gjenden të izoluar për arsye sigurie, sepse konsiderohen të dyshuar ose janë akuzuar ose që janë duke u gjykuar për kryerjen e një vepre penale, realizohet në përputhje me procedurën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni në institucionin e izolimit, bazuar në kërkesat me shkrim që këta persona i dërgojnë Përfaqësuesit ose Komitetit Përfaqësues të nismës ligjvënëse nëpërmjet administratës së institucionit përkatës të izolimit.

3. Zgjedhësit, të cilët banojnë jashtë territorit shqiptar gjatë mbledhjes së nënshkrimeve mund të nënshkruajnë fletët përkatëse në ambasada, misionet diplomatike të tjera, ose konsullata. Vendi dhe koha e mbledhjes së firmave përcaktohen nga kryetari i zyrës përfaqësuese përkatëse dhe njoftohen në mënyrën që siguron akses të plotë për shtetasit shqiptarë.

4. Në rastet e mësipërme, ngarkohen Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues, që të bashkëpunojnë me institucione të tjera shtetërore me qëllim që të lehtësojnë procesin e mbledhjes së nënshkrimeve për kategoritë e veçanta të personave që mbështesin nismën.

## **Neni 13**

### **Mbledhja e nënshkrimeve Online**

1. Nënshkrimet mund të mblidhen edhe online përmes Portalit (**EMERTIMI**) ose sistemeve të tjera online të zgjedhura nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës për këtë qëllim, sipas kushteve dhe standardeve teknike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nënshkrimin elektronik dhe ofruesit e shërbimeve të certifikimit.
2. Ofruesit e shërbimeve të certifikimit për mbledhjen online të nënshkrimeve për nismën, si dhe Administratori i Portalit sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale dhe identifikimin e nënshkrimeve. Mbledhja e nënshkrimeve online bëhet pa pagesë.
3. Pas çdo nënshkrimi online në Portalin e caktuar për këtë qëllim, sistemi duhet të printojë një Certifikatë që provon regjistrimin.
4. Në përfundim të afatit 30 ditor të mbledhjes së nënshkrimeve administratori i portalit i dorëzon Përfaqësuesit/Komitetit Përfaqësues të nismës certifikatat e printuara, të cilat dorëzohen KQZ bashkë me fletët e nënshkrimeve.

#### **Neni 14**

##### **Afati i mbledhjes së nënshkrimeve**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të Përfaqësuesit apo Komitetit Përfaqësues të nismës për pajisjen e tyre me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve përcakton me vendim periudhën kohore, gjatë së cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve në vendet publike të caktuara nga Këshillat Bashkiakë.
5. Në çdo rast periudha kohore për mbledhjen e nënshkrimeve është 30 ditë kalendarike dhe ndërpritet tre ditë nga dita e zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin, Parlamentin Evropian, këshillat bashkiakë, ose referendumi kombëtar.
6. Fletët e mbledhjes së nënshkrimeve depozitohen në KQZ nga Përfaqësuesi ose Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënëse popullore, jo më vonë se dy ditë pas përfundimit të procesit të mbledhjes së tyre, së bashku me dokumentacionin shoqërues të kërkesave të zgjedhësve që nuk mund të nënshkruajnë në vendet publike, procesverbalet e GMN për mbështetësit e nismës, që për shkak të paaftësive fizike nuk mund të nënshkruajnë vetë, si dhe certifikatat e printuara të nënshkruesve online.

#### **Neni 15**

##### **Verifikimi i Fletëve të Nënshkrimeve**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon fletët e nënshkrimeve brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:
  - a) të regjistrojë nismën ligjvënëse popullore;
  - b) të caktojë një afat kohor për plotësimin ose korrigjimin e pasaktësive gjatë depozitimit të saj;
  - c) të refuzojë regjistrimin e nismës nëse ajo është e paplotë në formë ose përmbajtje.
2. KQZ-ja, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe mund të konsultohet me ekspertë.
3. Në rast të mospërputhjeve të informacionit që përmbahet në Fletët e nënshkrimeve gjatë procesit të verifikimit, KQZ informon Përfaqësuesin ose Komitetin Përfaqësues të nismës, me



qëllim që të rregullojë, përmirësojë ose korrigojë Listën, për një afat jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e kthimit të saj.

3. Pas ridepozitimit në KQZ të Listës së Rishikuar, KQZ bën sërish verifikimet përkatëse dhe në rast se e gjen listën të rregullt, njofton Përfaqësuesin ose Komitetin Përfaqësues të nismës ligjvënëse brenda 2 (dy) ditëve, si dhe e publikon atë në faqen e saj të internetit.

## **Neni 16**

### **Depozitimi i kërkesës për nismën ligjvënëse popullore në Kuvendin e Shqipërisë**

1. Projektligji i plotë ose sipas rastit propozimi për hartimin e një ligji, së bashku me dokumentet që përshkruajnë dhe analizojnë qëllimin që ai kërkon të arrijë, së bashku me Vendimin e KQZ-së për regjistrimin e nismës ligjvënëse popullore, depozitohet në Kuvendin e Shqipërisë nga Përfaqësuesit apo Komiteti Përfaqësues i nismës.

2. Projektligji i plotë ose sipas rastit, propozimi për hartimin e një ligji, depozitohet nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës në Byronë e Kuvendit dhe Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet në Kuvend, sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të RSH për hartimin e akteve normative.

3. Procedurat e përfshirjes së projektligjit ose sipas rastit propozimit për hartimin e një ligji në programin e punës së Kuvendit realizohen nga Konferenca e Kryetarëve, sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit të RSH.

4. Kundër vendimit të Kuvendit për mospranimin e nismës apo në rast të mosveprimit të tij për një periudhë kohe më të gjatë se 6 muaj nga dita e depozitimit të nismës, Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës ka të drejtë të paraqesë ankim tek Kryetari i Kuvendit, i cili duhet ta shqyrtojë atë brenda 15 ditëve.

5. Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës, si dhe ekspertët e thirrur prej tij, kanë të drejtë të përfaqësojnë nismëtarët në të gjitha procedurat që do të ndiqen nga Kuvendi për hartimin ose miratimin e nismës, sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit të RSH.

## **KREU**

### **ANKIMET DHE SANKSIONET**

#### **Neni**

#### **Ankimi ndaj vendimit të KQZ**

1. Kundër vendimit të KQZ-së për refuzimin e regjistrimit të fletëve të nënshkrimeve mbështetëse të nismës ligjvënëse popullore, Përfaqësuesi ose Komiteti Përfaqësues i nismës ka të drejtë të paraqesë ankim në Kolegjin Zgjedhor.

2. Ankesat në çdo rast shqyrtohen sipas parashikimeve të legjislacionit zgjedhor në fuqi.

#### **Neni**

#### **Organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit**

Organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i Nismës, si dhe organet e qeverisjes vendore. Me qëllim

zbatimin e plotë të ligjit, organet dhe strukturat e mësipërme mund të vendosin marrëdhënie bashkëpunimi sipas rastit edhe me institucione të tjera shtetërore apo agjensi qeveritare, si dhe me organizata të shoqërisë civile.

### **Neni Sanksionet**

Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji apo shkelja e tyre përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 100000 lekë, me përjashtim të rasteve kur përbëjnë vepër penale.

### **Neni Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare.

## RELACION SHPJEGUES

# I PROJEKTLIGJIT 'PËR NISMËN LIGJVËNËSE POPULLORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË'

### I. Qëllimi i projektligjit dhe objektivat që synohen të arrihen

Qytetarë të angazhuar në çështjet që shqetësojnë shoqërinë tonë ndjejnë nevojën të përfshihen në punët dhe vendimmarrjet publike, përmes ushtrimit të nismës ligjvënëse popullore. Zhvillimi i vendit ka nevojë të vazhdueshme për nisma të tilla. Por, një përfshirje e tillë civile nuk është praktikisht e realizueshme apo funksionale me mekanizmat ligjore që ekzistojnë aktualisht. Kushtetuta e RSh ka parashikuar të drejtën e 20000 zgjedhësve për të propozuar një ligj në Kuvend, por nuk ka një rregullim të sistematizuar të procedurave përkatëse, ndërkohë që ato duhet të parashikohen me ligj. Deri më sot kemi pasur pak nisma të tilla dhe vetëm njëra prej tyre është kurorëzuar me miratimin në Parlament të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (Ligj nr. 9669, dt. 18.12.2006). Në këto përvoja është evidentuar qartë nevoja e krijimit të kuadrit të përshtatshëm ligjor për ndërmarrjen dhe ushtrimin e kësaj nisme. Një këndvështrim i ri ndikohet jo vetëm nga zhvillimet për rritjen e të drejtave të pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen e vendit, por edhe nga zhvillimet e vazhdueshme të teknologjisë së lartë. Aktualisht, në demokracitë evropiane e drejta e pjesëmarrjes po shihet e lidhur ngushtë me të drejtën parlamentare dhe po kërkohet rritja e parashikimeve ligjore për të garantuar këto të drejta. Në këto kushte, promovimi i nismës ligjvënëse popullore, si pjesë e institucioneve kushtetuese të demokracisë së drejtpërdrejtë, është i nevojshëm dhe imediat.

Nisma e drejtpërdrejtë ligjvënëse është sanksionuar tashmë edhe në rendin juridik evropian. Traktati i Bashkimit Evropian, me ndryshimet e sjella nga Traktati i Lisbonës (2009), sanksionon shprehimisht: *“Të paktën 1 milion qytetarë të Bashkimit, që kanë shtetësinë nga një numër i konsiderueshëm i Shteteve anëtare, mund të ndërmarrin iniciativë për të dërguar në Komisionin Evropian një propozim të përshtatur mbi një çështje, në të cilin qytetarët e konsiderojnë të nevojshëm një akt juridik të Bashkimit, me qëllim zbatimin e traktateve”*<sup>1</sup>. Është e qartë se iniciativa e drejtpërdrejtë e qytetarëve evropianë përfaqëson një dimension të ri të vetë demokracisë në Bashkimin Evropian. Tashmë që nga viti 2009 është hartuar edhe Libri i Gjelbër (COM (2009)622)<sup>2</sup>, i cili përmban rregulla të rëndësishme për të bërë realitet iniciativën të tilla.

<sup>1</sup> Traktati i Lisbonës, 1 Dhjetor 2009, art. 11, parag.4.

<sup>2</sup> Shih më gjerë: Caterina Bova, “Il diritto d’iniziativa dei cittadini europei ed i confermati limiti dell’iniziativa legislativa popolare in Italia”, në websit: [http://www.forumcostituzionale.it/site/images/stories/pdf/documenti\\_forum/euroscopio/note\\_europa/0008\\_bova.pdf](http://www.forumcostituzionale.it/site/images/stories/pdf/documenti_forum/euroscopio/note_europa/0008_bova.pdf), vizituar për herë të fundit më 02.09.2014

Në këtë kuadër, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, në bashkëpunim me aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile, me qytetarë të angazhuar në çështjet publike, me universitetet dhe me ekspertë profesionistë, ka hartuar projektligjin për 'Nismën Ligjvënëse Popullore'. Ky projektligj u krijon mundësinë reale zgjedhësve/qytetarëve, si dhe organizatave të shoqërisë civile që të dërgojnë në Kuvend propozime të plota ligjesh për miratim ose të ndërmarrin nisma sipas të cilave t'i kërkojnë Kuvendit të shqyrtojë çështje/ligje, me iniciativën e tij.

Projektligji qw paraqitet ka qëllim të rregullojë në mënyrë të detajuar procesin dhe procedurat në bazë të të cilave do të ndërmerret nisma ligjvënëse popullore nga 20 mijë zgjedhës/shtetas me të drejtë vote, duke filluar nga momenti i regjistrimit të nismës, në modalitetet e funksionimit dhe përfaqësimit të saj nga organizatat e shoqërisë civile apo qytetarët e angazhuar, në krijimin e Grupeve të Mbledhjes së Nënshkrimeve, në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve, procesin e verifikimit të tyre nga KQZ, e deri në dërgimin/depozitim të tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

## **II. Argumentimi i projektligjit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme**

Projektligji për Nismën Ligjvënëse Popullore pritet të sjellë një risi në procesin e jetësimit të Kushtetutës së Shqipërisë dhe demokracisë popullore, duke e bërë atë më të efektshme dhe aktive, pasi i krijon mundësi reale si shoqërisë civile nëpërmjet organizatave të saj, edhe qytetarëve të angazhuar në çështje civile që të ushtrojnë nisma ligjvënëse. Ata mund të mbledhin nënshkrimet e 20 000 (*ose më shumë*) zgjedhësve, të cilët ndodhen në territorin e Shqipërisë ose jashtë saj; , Nismëtarët mund të paraqesin të plotë projektin dhe t'i kërkojnë Kuvendit të Shqipërisë miratimin e tij, por mund të ushtrojnë nismën edhe duke i paraqitur thjesht një kërkesë Kuvendit për të shqyrtuar/miratuar një ligj në të ardhmen. Një rol të veçantë në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse të nismës pritet të luajë shoqëria civile dhe qytetarët e angazhuar në çështje civile, nëpërmjet koordinimit të punës mes tyre, si dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Kuvendin e Shqipërisë, apo institucione të tjera që eventualisht mund të përfshihen në proces (*p.sh Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit*).

Ligji gjithashtu sjell një risi tjetër pasi i krijon mundësinë mbështetësve të nismës që përfshirjen e tyre ta realizojnë edhe online, nëpërmjet nënshkrimit të tyre jo fizikisht, por nëpërmjet një portali të dedikuar për këtë qëllim, i cili do të gjenerojë edhe certifikata të printuara krahas të dhënave elektronike që mund të mblidhen/gjenerohen online.

Projektligji ngërthen standardet dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe parimet e trashëgimisë elektorale evropiane, duke referuar frymën dhe praktikën e Rregullores Nr. 211/2011<sup>3</sup> të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në 16 Shkurt, 2011 për 'Iniciativën Ligjvënëse Popullore në BE', standardet e parashikuara nga Kodi i Praktikave të Mira për Referendumet<sup>4</sup> (2007) të Komisionit të Venecias si dhe modeleve të ligjeve për nismat/iniciativat ligjvënëse qytetare/popullore të shteteve të tjera si Itali, Austri, Letoni, Kosovë, Portugali, Spanjë, Hungari, Poloni dhe Slloveni.

Në këtë kuadër, pritet që miratimi i ligjit fillimisht, të rrisë iniciativat ligjvënëse të qytetarëve në çështje ku ata kanë interes ose ndeshen me problematika që shqetësojnë komunitetin e vetiu, kërkojnë ndërhyrje e masa legjislative; miratimi dhe zbatimi i këtij ligji do të ndryshojë jo vetëm kulturën dhe mendësinë e pjesëmarrjes/angazhimit civil, por edhe do të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për t'u përfshirë në punët publike nëpërmjet nismave ligjvënëse. Në një afat më të gjatë pas miratimit të këtij ligji, pritet që të rritet cilësia e nismave ligjvënëse të ndërmarra, të rritet shkalla e bashkëpunimit të organizatave të shoqërisë civile, si dhe të rriten kapacitetet njerëzore për t'u përfshirë në këto nisma.

### **III. Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin**

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e RSH si dhe me të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi. Gjithashtu, projektligji reflekton standardet dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe parimet e trashëgimisë elektorale evropiane.

Kështu, nëse i referohemi Kushtetutës së RSh, e cila u miratua me referendum popullor në vitin 1998, Neni 2/2 parashikon parimisht '*Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti*' Neni 81 i Kushtetutës, që rregullon procesin ligjvënës, e orienton demokracinë e drejtpërdrejtë vetëm në procesin legjislativ propozues kur parashikon se '*të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës*'. Në këtë kontekst projektligji përmbush një nga detyrimet më të rëndësishme kushtetuese, atë të realizimit në praktikë me rregulla të qarta procedurale që garantojnë vullnetin propozues qytetar, të nismës ligjvënëse popullore.

### **IV. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me *acquis communautaire***

---

<sup>3</sup> Për më shumë, teksti i plotë i Rregullores 211/2011 gjendet në faqen e internetit <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV:ai0044>

<sup>4</sup> Për më shumë lexo [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2007\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2007)008-e)

Projektligji për 'Nismën Ligjvënëse Popullore' është hartuar në frymën dhe praktikën e Rregullores Nr. 211/2011<sup>5</sup> të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të miratuar në 16 Shkurt, 2011 për 'Iniciativën Ligjvënëse Popullore në BE', duke eksploruar dhe duke konsultuar modele të ligjeve për nismat/iniciativat ligjvënëse qytetare/popullore të shteteve të tjera si Itali, Austri, Letoni, Kosovë, Portugali, Spanjë, Hungari, Poloni dhe Slloveni.

Për hartimin e projektligjit janë konsultuar gjerësisht edhe materiale të përgatitura nga Komisioni i Venecias, në mënyrë të veçantë Kodi i Praktikave të Mira për Referendumet<sup>6</sup> (2007) - Kreu IV, i cili i kushton vëmendje procesit të mbledhjes dhe verifikimit të nënshkrimeve.

## **V. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektligjit**

Projektligji për 'Nismën Ligjvënëse Popullore' është i organizuar në katër Krerë/Kapituj.

**Kreu i Parë** titullohet 'Dispozita të Përgjithshme' dhe parashikon qëllimin e tij, parimet bazë për realizimin e procesit të nismave ligjvënëse popullore, si dhe përkufizimet dhe terminologjinë e draftit të ri të propozuar.

**Kreu i Dytë** i dedikohet në detaje mënyrës dhe procedurave në bazë të të cilave do të realizohen nismat ligjvënëse popullore. Dispozitat e kësaj pjese i parashikojnë llojet e nismave ligjvënëse popullore, kategoritë e qytetarëve që mund të iniciojnë këto nisma, mënyrën e financimit të nismave nga vetë Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës, mënyrën e funksionimit dhe regjistrimit të Përfaqësuesit/Komitetit Përfaqësues të nismës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, afatet e regjistrimit të nismës dhe rolin e KQZ në këtë proces, rolin e organizatave të shoqërisë civile apo të qytetarëve të angazhuar në çështje civile në procesin e regjistrimit të nismës, deri në mbledhjen e plotë të nënshkrimeve, si dhe dispozita që rregullojnë procedurën e njoftimit të Kuvendit të Shqipërisë për nismën dhe publikimin e saj në media dhe rrjete sociale.

**Kreu i Tretë** parashikon të detajuar procesin e mbledhjes së nënshkrimeve, procesin e përcaktimit dhe miratimit të Vendeve të Mbledhjes së Nënshkrimeve/VMN (*sipas parimit 1 vend publik për çdo 5000 zgjedhës*) nga Këshillat Bashkiakë, mënyrën e përbërjes dhe modalitetet e funksionimit të Grupeve të Mbledhjes së Nënshkrimeve/GMN, që përbëhen nga dy anëtarë, të cilët caktohen nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës nga radhët e aktivistëve të grupeve sociale, qytetarëve të angazhuar apo organizatave të shoqërisë civile që kanë iniciuar nismën, sipas modaliteteve të përcaktuara në Memorandumet e Bashkëpunimit të nënshkruara paraprakisht për këtë qëllim. Kreu i Tretë parashikon gjithashtu edhe modalitetet e Fletëve të

---

<sup>5</sup> *Supra, Ref. # 1*

<sup>6</sup> *Supra, Ref. # 2*

Mbledhjes së Nënshkrimeve (*Fletët tip*), të cilat miratohen nga KQZ, dhe duhet të përmbajnë këto elementë:

- numrin rendor
- gjeneralitetet e zgjedhësve që mbështesin nismën
- vendin dhe datën e lindjes së zgjedhësve
- numrin e Kartës së Identitetit apo të Pasaportës të mbështetësve
- kolonën ku ata nënshkruajnë
- emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e anëtarëve të GMN të përfshirë në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve.

Një nen i veçantë në ligj i dedikohet edhe procedurave të posaçme për shtetasit shqiptarë me të drejtë vote që nuk janë në gjendje të shkojnë në vendin e mbledhjes së nënshkrimeve për arsye shëndetësore, për shtetasit shqiptarë me të drejtë vote që gjenden të izoluar për arsye sigurie, sepse konsiderohen të dyshuar, ose janë akuzuar, ose që janë duke u gjykuar për kryerjen e një vepre penale.

Projektligji sjell risi, pasi parashikon mundësinë që zgjedhësit që banojnë jashtë territorit shqiptar të mund të nënshkruajnë fletët përkatëse në ambasada, misione diplomatike të tjera, ose konsullata, si dhe kur është rasti aniline. Për këtë qëllim vendi dhe koha e mbledhjes së firmave përcaktohet nga kryetari i zyrës përfaqësuese përkatëse dhe zgjedhësit kanë mundësi të njoftohen në mënyrën që siguron akses të plotë për shtetasit shqiptarë.

Risi tjetër është gjithashtu edhe procesi i mbledhjes online së nënshkrimeve mbështetëse të nismave, nëpërmjet një Portali online ose sistemeve të tjera online të cilat zgjidhen/identifikohen nga Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës për këtë qëllim, sipas kushteve dhe standardeve teknike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nënshkrimin elektronik dhe ofruesit e shërbimeve të certifikimit.

Ky kre parashikon gjithashtu marrëdhëniet dhe rolin e KQZ në procesin e përgatitjes dhe dorëzimit të *Fletëve tip*/Fletëve për Mbledhjen e Nënshkrimeve tek Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës, afatet për mbledhjen e nënshkrimeve që është 30 ditë kalendarike nga dita e marrjes në dorëzim të tyre, parashikon procesin e dorëzimit të tyre në KQZ dhe procesin e verifikimit të Fletëve të Mbledhjes së Nënshkrimeve nga KQZ, të drejtën e KQZ për të verifikuar informacionet e nënshkrimeve e në rast se vëren mospërputhje apo konstaton probleme/parregullsi parashikohet mundësia që Përfaqësuesit/Komitetit Përfaqësues t'i kthehen listat për t'i rregulluar, plotësuar, përmirësuar ose korrigjuar atë, parashikohen afate për secilën fazë të procesit, si dhe procedurat dhe afatet për Depozitimin e kërkesës për nismën ligjvënëse popullore në Kuvendin e Shqipërisë.

Më tej, **Kreu i Katërt** parashikon mundësinë e ankimit të Përfaqësuesit/Komitetit Përfaqësues të nismës në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimit të KQZ për refuzimin e regjistrimit të fletëve të nënshkrimeve mbështetëse të nismës, sanksionet për mos-respektimin e dispozitave të ligjit të cilat konsiderohen kundravajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

## **VI. Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e ligjit**

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e ligjit janë:

- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** i cili regjistron Nismën, miraton shpërndan dhe kontrollon Fletët e Mbledhjes së Nënshkrimeve
- **Këshillat Bashkiakë** në procesin e miratimit të Vendeve të Mbledhjes së Nënshkrimeve
- **Kolegji Zgjedhor** ku mund të behët ankim kundër vendimit të KQZ për refuzimin e regjistrimit të fletëve të nënshkrimeve mbështetëse
- **Kuvendi i Shqipërisë**, institucioni ku depozitohet nisma ligjvënëse popullore apo kërkesa për miratimin e një ligji.

## **VII. Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit**

Nisma për draftimin e projektligjit dhe realizimin e lobimit për miratimin e tij është ndërmarrë nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare/QLN, nëpërmjet projektit 'Zbatimi dhe forcimi i nismave ligjvënëse qytetare të parashikuara në Kushtetutë, përmes përmirësimeve ligjore dhe rritjes së aktivizmit të shoqërisë civile', me mbështetjen e Fondacionit 'Shoqëria e Hapur për Shqipërinë'. QNL mbështetet fort në eksperiencën e krijuar nga shoqëria civile shqiptare për ushtrimin e nismave ligjvënëse popullore.

QNL e ka finalizuar këtë projekt me disa partnerë të rëndësishëm si, Departamenti i të Drejtës Publike i FD-Univeristetit i Tiranës, si dhe fakultete të tjera pranë Universiteteve, Vlorë, Durrës, e Shkodër. Gjithashtu, partnerë të rëndësishëm janë edhe disa OJF që kanë ndërmarrë nisma të ngjashme si, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Res Publica, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Qendra Komunitare Sot për të Ardhmen, Durrës, Qendra Gruaja tek Gruaja, Shkodër. etj.

## **VIII. Shpenzimet buxhetore që lidhen me miratimin e projektligjit**

Kostot e nismës ligjvënëse popullore, procesit të mbledhjes së nënshkrimeve dhe komunikimi/regjistrimi i nismës në KQZ deri në depozitim të nismës në Kuvendin e Shqipërisë, mbulohen nga vetë Përfaqësuesi/Komiteti Përfaqësues i nismës. Në këtë këndvështrim nuk ka asnjë kosto buxhetore.



Kosto paraqet vetëm procesi i prodhimit/shumëfishimit të Fletëve të Mbledhjes së Nënshkrimeve nga KQZ, megjithatë kjo është e papërfillshme<sup>7</sup> në Buxhetin e KQZ; në çdo rast KQZ mund ta shtojë këtë zë (*ndonëse i papërfillshëm*) në Buxhet në momentin e hartimit të projekt-buxhetit për vitin pasardhës.

---

<sup>7</sup> Kosto mesatare e prodhimit të një Fletë të Mbledhjes së Nënshkrimeve me 20 zgjedhës është 40 Lek. Per procesin e mbledhjes së nënshkrimeve KQZ mund të prodhojë rreth 3000 fletë që kanë një kosto prej 120,000 lekësh në total (*3000 fletë X 40 Lek/fletë*).